

K O N T R A T E

P E R

THEMELIMIT DHE ANKIVITETET E SHOQERISE " M E SH " shpk

lidhur ndërmjet :

- 1- Larta Gino, e bija e Edues, e dt. 1951, e rreson në Lushnje.
- 2- **Zihni** Shaga, i biri i **Saliut**, i dt. 1953, anues në Durres.
- 3- Sulejta Kastrioti, i biri i Jonanit, i dt. 1960, anues në Durres.

Ortakët kanë rënë dakort si më poshte:

Neni 1

Themelohen Shoqëria me Përgjegjësi të kufizuar me emrin  
" M E SH " shpk, për të ushtruar aktivitet ekonomik  
tregtar të përcaktuar më poshte.

Neni 2

Shoqëria ka statusin e personit juridik shqiptar dhe selinë  
e saj ka të qendrueshme.

Neni 3

Veprimtaria e shoqërisë, marrëdhëniet që lindin nga kjo kontratë  
si dhe marrëdhëniet e saj me personat e tretë vendos dhe të rregullohen  
në ligjin Nr. 7638 datë 19.11.1992 dhe sipas dispozitivave të kësaj kontrate  
dhe statutit bashkëlidhur.

Neni 4

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ajo nuk përgjigjet  
për detyrimet që ortakët e saj marrin përsiper si person fizik të  
tejt veprimtariës së kësaj shoqërie, po kështu ata nuk përgjigjen  
për detyrimet e shoqërisë dhe nuk përballojnë humbjet e saj të  
kontributit të venë nga secili. Shoqëria gjithashtu nuk përgjigjet  
për detyrimet që ortakët e saj kanë pasur përpara themelimit, si  
person fizik.

Veprimtaria e shoqërisë, emertimi dhe selia e saj të përcaktuara  
në këtë kontratë nuk mund të ndryshojnë pa pëlqimin e paleve.

Neni 5

Shoqëria ka për objekt të veprimtariës së saj blerjen dhe tregtimin  
në shumicë e pakicë të karburantëve, të lendeve djegëse,  
në shumicë e pakicë për popullatën, vajra lubrifikante, lavazh makinash,  
servise automjeteve si dhe tregtimin e mallrave të ndryshme,  
si dhe transport karburantesh e mallrash të ndryshme.

Neni 6

Kapitali themelor i shoqerise eshte ne shumen prej 100000 leke. Duke marre parasysh kontributin e dhene prej secilit ortak ne formimin e kapitalit themelor, pjesa e secilit ortak eshte 33.33% Marta Gina, 33.33% Shqifet Kastrati, 33.33% Edmond Shega. Ne librin e llogarise se shoqerise krijohet fondi themelor i ortakeve ku shenohen kapitalet e vena nga secili ortak. Ortaket nuk kufizohen ne rritjen e kontributit te tyre.

Neni 7

Shoqeria fillon veprimtarine e saj pas marrjes se autorizimit dhe miratimit nga organet tatimore.

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte 10 vjet. Ortaket kane te drejte te heqin dore nga kjo kontrate duke njoftuar me shkrim organin kompetent te kesaj shoqerie sic percaktohet ne statut.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga shoqeria pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe zbritjes se fondeve, ndahet nga ortaket perpjestimisht me pjesen qe u takon secilit ne kapitalin thmelor.

Neni 9

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori
- Komisioni i revizionimit

Modalitetet e formimit dhe funksionit te tyre percaktohen ne statutin e bashkalidhur.

Neni 10

Ortaket detyrohen te ruajne karakterin e fshehte te dokumentacionit, te informatave, te njohurive dhe te pervojës se fituar ose te shkëmbyer e te realizuar ne kuadrin e shoqerise dhe te marre te gjitha masat e nevojshme per te shmangur perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht.

Ortaket pergjigjen per pasojat e demshme te nje shkeljeje te mundshme te ketij detyrimi, kur kjo shkelje eshte rrjedhoje e ndonje veprimi te qellimte ose nga pakujdesia.

Neni 11

Mosmarreveshjet qe ~~lindin~~ mund te lindin midis ortakeve dhe qe nuk zgjidhen me ane bisedimesh do t'i nenshtrohen gjykimit ne gjykatën e rrethit Durres.

Neni 12

Dispozitat me te hollesishme per shoqerine percaktohen ne sattetin e saj bashkalidhur.

Neni 13

Kjo kontrate u redaktua ne kater kopje, nga te cilat njera dorezohet ne gjykatën e rrethit Tirane, njera ne zyrene noterise, nje kopje ne Degen e Tatimeve dhe nje tjetër mbahet ne dokumentacionin e shoqerise.

O R T A K E T

Marta Gina

Zihni Shega

Shefqet Kstrati

REPUBLIKA SHQIPËRISË

DHOMA E NOTEREVE DURRES

Nr. 1486 tep. nr. 63P kel

V E R T E T I M

Sot me njezeteshtate prill te muajit te vitit njemijente qintnentedhjetepese (27.4.1995) ditën e enjte ne qytetin e Durresit para noterit Piro Tili u paraqiten z. Marta Gila, Zihni Shega, Shefqet Kstrati, identitetin e tecileve u sigurova sipas rregullit dhe te cilat nenshkruan rregullisht kete kontrate.

Une noteri vertetoj .....

NOTERI  
/PIRO TILI /



# S T A T U T I

## I

### SHOQERISE "M E SH" SH.P.K. SHKOZET

#### Neni 1

Shoqeria "M E SH" shpk eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perfaqesohet nga ortaket Marta Gina, Zihni Shega she Shefqet Kastrati, me administrator Marta Gina.

#### Neni 2

Shoqeria ka kete statut ne perputhje me kontraten e themelimit te saj dhe me ligjin nr7638 dt 10.11.1992 qe rregullon poziten juri dike te ortakeve dhe te punonjesve te shoqerise, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise te shoqerise dhe te ceshtjeve te tjera me rendesi per punen e saj.

#### Neni 3

Shoqeria ka statutin e personit juridik dhe vulen e saj. Ajo zhvillon veprimtarihe e saj ne perputhje me ligjin si me siper dhe me dispozitat e parashikuara ne kontraten e themelimit dhe me kete statut.

#### Neni 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj blerjen dhe tregtimin me shumice e pakice te karburanteve, te lendeve djegese me shumice e pakice per popullaten, ta vajrave lubrifikante, lavazh mash, servis automjetesh, te tregtimit te mallrave te ndryshem e transport.

#### Neni 5

Shoqeria e ka seline ne Shkozet te rrethit Durres, por ajo mund te cele dege e filiale e perfaqesi ne te gjitha territorin e Shqiperise ne perputhje me ligjet.

#### Neni 6

Ne perputhje me kontraten e themelimit per krijimin e kapitalit themelor te shoqerise ortaket kane investuar nje shume prej 100000 lekesh e cila eshte ne pronesi te perbashket dhe ne masen 33,33% Marta Gina, 33,33% Zihni Shega, 33,33% Shefqet Kastrati.

#### Neni 7

Pjesemarresit ne kapitalin themelor te shoqerise ruajne te drejten e tyre te pronesise ne shoqeri, por kjo nuk i pengon ata te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte shoqerise. Ortaket qe marrin pjese ne shoqeri nuk i nenshtrohen asaj si person, ata nuk pergjigjen per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike tregtare e shoqerise tej kapitalit qe ata kane kontribuar per themelimin dhe funksionimin e saj. Po keshtu shoqeria nuk pergjigje per detyrimet e ortakeve te saj jashte kesaj veprimtarie.

Neni 8

Ortakët nepermjet asamblese se tyre kanë të drejtë të marrin pjesë e të kërkojnë të dhëna mbi administrimin e veprimtarisë ekonomike miko tregtare të shoqërisë dhe mbi rezultatet e saj, të bëjnë propozime në këto drejtim për shqyrtim në asamble në përputhje me këtë statut dhe kontratë të themelimit. Ata janë të detyruar të marrin pjesë në punët e shoqërisë, të japin informata të ndryshme në interes të aktivitetit të saj, të realizojnë shërbime për këto qëllime etj., në përputhje me kontratën e statutin.

Neni 9

Cdo ortak ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria duke ia bërë të ditur vendimin e tij me shkrim shoqërisë tre muaj më parë. Heqja dorë nuk e liron ortakun nga obligimet e marra me parë ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakëve.

Ortaku i cili heq dorë duhet t'i ofrojë pjesën e tij ortakëve të tjerë dhe kur ortakët e tjerë nuk pranojnë blerjen brenda 30 ditëve nga njoftimi ortaku dorëheqës mund t'ua shesë pjesën e tij personave të tretë por me kusht që çmimi dhe mënyra e pagesës të mos ndryshojë.

Neni 10

Marrja në punë në shoqëri bëhet me kontratë në të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve në përputhje me ligjin për marrëdhëniet e punës. Kontratën me cdo punonjës e lidh drejtori i shoqërisë.

Neni 11

Mosmarrëveshjet që lindin midis ortakëve dhe që nuk zgjidhen me anë të bisedimesh do të nënshtrohen gjyqimit në gjykatën e rrethit.

Neni 12

Shoqëria përcakton fondin themelor dhe fondin rezervë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj ajo mund të përcaktojë dhe fonde të tjera.

Formimi i fondit themelor dhe i fondeve të tjera si dhe përdorimi i tyre bëhet nga drejtori me vendim të asamblese dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 13

Shoqëria është pronare për ato sende për të cilat gezon këto të drejta dhe për të tjera në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj, por mund të blejë dhe të shfrytëzojë edhe të drejta të tjera materiale duke përfshirë këtu edhe të drejtën për të ofruar pasurite e veta.

Neni 14

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen të gjitha

detyrimet qe ka pjesen e mbetur te kapitalit dhe t'ardhurave ua ndan ortakeve ne perpjestim me kuoten e vene prej secilit per krijimin e kapitalit themelor.

Neni 15

Fitimi i realizuar ne shoqeri ndahet ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themelor.

Neni 16

Rrezikun e humbjeve eventuale nga afarizmi i shoqerise e bartin ortaket ne perpjestim me mjetet e investuara per themelimin e shoqerise. Humbjet kompensohen nga e tere pasuria e shoqerise.

Ne rast se humbja e shakttuar per fajin ekskluziv te njerit prej ortakeve atehere ky eshte i detyruar te kompensoje demin me mjetet e tij private.

Neni 17

Pasurite shoqerore vleresohen ne bilancet e saj ne vlerat e shprehura ne leke por dhe ne valute te huaja ne perputhje me ligjin mbi kontabilitetin.

Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike te shoqerise caktohen nga drejtori (Administratori) duke patur parasysh dhe formen e bilanceve dhe te llogarive ekonomike te vendosura per shoqerite et.

Bilanci vjetor duhet te paraqitet brenda muajit mars te vitit pasardhes.

Neni 18

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori
- Komisioni i revizionimit

Administratori i shoqerise emerohet Marta Gina.

Neni 19

Asambleja e ortakeve eshte organ vendimor dhe perbehet nga ortaket e shoqerise te cilet realizojne te drejtat dhe detyrimet e tyre neper mjet vendimeve te marra nga asambleja e ortakeve.

Asambleja e ortakeve kryesohet nga administratori i cili ka kompetenca te percaktuara ne kete statut, ajo mblidhet jo me pak se dy here ne vit.

Neni 20

Administratori i shoqerise eshte organ vendimor dhe ka keto te drejta dhe detyra:

- therret asamblene e ortakeve
- miraton programet dhe llogarite ekonomike
- emerom dhe shkarkon komisionin e revizionit

- paraqet propozime per pushimin e veprimtarise
- lidh kontrata
- perfageson shoqerine ne persona te trete
- percakton numrin e punonjesve dhe pagat e tyre.

Neni 21

Veprimtaria operative e shoqerise organizohet dhe drejtohet nga e administratori i saj, i cili vepron ne te gjithë sektoret e shoqerise per ndjekjen dhe realizimin e veprimtarise te percaktuar ne objektin e shoqerise duke u mbashtetur ne dispozitat ligjore.

Neni 22

Per te kontrolluar veprimtariet financiare dhe ekonomike tregtare e shoqerise dhe filialeve te mundshme te saj, krijohet komisioni i revizionit i perbere nga nje kryetar dhe nga revizoret, te cilet emerohen nga administratori per nje afat te percaktuar kohe. Kryetari dhe anetarret e komisionit nuk duhet te jene punonjes te shoqerise dhe te filialeve te saj.

Komisioni i revizionit eshte pergjegjes per veprimtariet e vet para administratorit dhe i paraqet qatij raporte me shkrim per kontrollin e kryera.

Neni 23

Shoqeria e pushon veprimtariet e saj ne cdo rast qe e vendos asambleja e ortakeve. Ne kete rast administratori emerohet komisionin e likuidimit i cili paraqet bilancin e likuidimit. Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin kur asambleja miraton bilancin e likuidimit. jetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise ose te filialeve te saj ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me pjesen

e tyre te kapitalit pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 24

Ky statut u redaktua ne kater kopje, nga te cilat njera dorezohet ne gjykatën e rrethit Tirane, nje kopje ne zyren e noterise, nje kopje ne degen e tatim taksave te rrethit dhe nje kopje mbahet ne dokumentacionin e shoqerise.

Marta Gina

O R T A K E T

Zihni Shega

Shefqet Kastrati